

## GLAUCOMA – A ESHTË E MUNDUR TE RREZIKOHENI?

### **Rasti I pacientit te pare:**

*Nje hidraulik I cili po punonte ne nje ndertese u tmerrua kur partneri qe punonte me te papritur flaku nje cekan te rende ne drejtim te tij I cili pothuaj do t'i shkaktonte demtim serioz. Arsyeya? Hidrauliu qe hodhi cekanin nuk e pa fare shokun e tij, dhe pasi beri kontrollin mjekesor te syve pas kesaj ngjarjeje, rezultoi se kishte humbur shumicen e pamjes se asaj ane per shkak te glaukomes.*

### **Rasti I pacientit te dyte:**

*Nje burre te cilin e detyroi e shoquja qe te bente nje kontroll te syve gjate kohes qe ajo vajti vete per te marre syza te reja. Ai nuk pranoi ne fillim, duke protestuar se nuk kishte ndonje shqetesim me pamjen – por testi tregoi se edhe atij I kishte filluar glaucoma e cila kishte filluar t'i humbiste shikimin.*

Nese nuk e dini se cfare eshte semundja e syve qe quhet **GLAUKOMA**, nuk jeni vetem ju. Gjithashtu kjo eshte shkak i dymte qe shkakton humbjen e shikimit (drites se syve) ne te gjithë boten dhe I ndodh me shume se nje personi ne cdo 50 vete mbas moshes 40 vjecare ne Australi, dhe shumica e njerezve nku dine asgje rreth kesaj semundjeje te zakonshme te syve. Ata gjithashtu nuk e dine se sa e rendesishme eshte qe te besh rregullisht testing e glaukomes cdo 2-3 vjet mbas moshes 40 vjecare (ose mbi 35 per ata qe futen ne grupin me rrezik me te larte).

Gjeja me e rrezikeshme e glaukomes eshte se nuk mund ta kuptosh vete, shenjat nuk jane te dukeshme derisa syri te jete demtuar, si puna e hidraulikut, nje pjese e shikimit pothuajse ka humbur. Nje humbje qe eshte e parikthyeshme.

Glaukoma nuk eshte e kurueshme. Por nese do te zbulohet qe ne fillim glaucoma mund te kontrollohet duke shkaktuar demtim sa me te vogel te pamjes qe te jete a mundur. Nese do te trajtohet qe ne fillim, shumica e njerezve nuk e humbasin aspak shikimin gjate gjithë jetes se tyre.

Glaukoma nuk eshte nje infeksion dhe nuk eshte ngjitese. Eshte nje semundje e syrit qe shfaqet kur nje pjese shume e rendesishme e syrit qe quhet nervi optik demtohet – shkak eshte rritja e presionit te syrit kur grumbullohet shume uje (leng) Brenda ne sy. Ky presion I syrit shkaterron nervin optik, zakonisht ne menyre shume graduale, duke ndikuar ne shikimin anesor. Per shkak se demton pamjen anash, efektet zakonisht nuk kuptohet derisa humbet nje pamje me te madhe te shikimit.

Pamja anesore shete nje pjese shume e renderishme e shikimit; ne e perdorim automatikisht ne jeten e perditeshme gjate kryerjes se aktiviteve per siguri, si per shembull ngjitja dhe zbritja e shkalleve, ne rrugelalim, ne ngarjen e makine dhe ne levizje te tjera.

Glaukoma eshte aq e zakonshme sa edhe diabeti I te rriturve (lloji II) por gjithashtu jo vetem eshte me e mundur qe t'u shfaqet njerezve mbi moshen 40 vjecare, por mund te shfaqet ne cdo moshe zakonisht shfaqet ne femije dhe te rinj. Njerezit qe jane me ne rrezik t'u shfaqet semundja, jane ata qe kane histori te glaukomes ne familjen e tyre; ata qe vuajne nga diabeti, tensioni I larte I gjakut, migrena, nuk kane shikim te plote, kane pasur ndonje demtim te syrit, kane perdorur ose duhet te perdorin kortizone (steroide) jo vetem tani por edhe net e kaluaren.

Sapo glaucoma te zbulohet, trajtimi eshte I thjeshte. Mjekimi perfshin:

- **Ilac ne sy me pika.** Ky eshte mjekimi me I thjeshte – por duhet te perdoret rregullisht ne menyre qe te beje efekt. Nganjehere jepen edhe ilace.
- **Mjekimi me rreze laser.** Ky perdoret ne rastet kur ilaci me pika nuk eshte ne gjendje te ndaloje humbjen e shikimit. Rrezja laser eshte nje drite shume e perqendruar e cila perdoret ne shume trajtime te ndryshme mjekesore, per glaukome rrezja laser perdoret per te cliruar presionin e syrit nga grumbullimi I lengjeve ne sy.
- **Operacioni.** Mund te perdoret ne rast se ilaci me pika ose mjekimi me rreze laser nuk bejne efekt.

Nese jeni mbi moshen 40 vjecare dhe nuk e keni bere kontrollin e glaukomes, ose perfshiheni ne grupin e atyreve qe jane me ne rrezik, atehere ju duhet te beni testing e glaukomes. Testi eshte I thjeshte dhe mund te behet nga cdo doctor I syve. Kostoja eshte plotesisht e paguar nga Medicare ose nga inshurence private (nese ka individe qe jane te inshuruar).

Nese desheroni me shume informacion ne anglisht rreth glaukomes, kontaktoni Glaucoma Australia ne linjen telefonike falas **1800 500 880**. Glaucoma Australia ofron ndihme keshilluese per ata qe jane te ndikuar nga kjo semundje, ben mbledhje te rregullta ne grupe, boton dy here ne vit buletin *Glaucoma News* dhe organizon biseda edukative ne shoqata.

**Menyra qe mund te minimizoje humbjen e shikimit nga glaukoma eshte konstatimi I hershem dhe njekimi.**

**“Mbroni syte – shmangni glaukome verbuese”**

### **Glaucoma Australia**

PO Box 420 Crows Nest, NSW, 1585

1800 500 880

email: [glaucoma@glaucoma.org.au](mailto:glaucoma@glaucoma.org.au)

[www.glaucoma.org.au](http://www.glaucoma.org.au)



**GLAUCOMA  
AUSTRALIA INC**

Nje pjese e tekstit ne anglisht eshte marre nga *NSW Health Department, Multi Cultural Communication web page* <http://mhcs.health.nsw.gov.au> Data e publikimit: Shtator 1999; ribotuar ne Maj 2003

Perkthimi I ketij artikulli u mundesua nga ndihma e vleresuar e Arbiana Bianca Bido (Albanian interpreter)



**ETHNIC COUNCIL  
OF SHEPPARTON AND DISTRICT Inc.**

Reg. No. A6321